



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E INSPEKTIMIT DHE MBIKËQYRJES

Nr. 22/4 prot.

Tiranë, më 09.02.2026

V E N D I M

Nr. 11, datë 09.02.2026

**MBI PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VLERËSIMIT TË LIGJSHMËRISË, SË
PROCEDURËS SË KONKURRIMIT PËR PLOTËSIMIN E POZICIONIT
“SPECIALIST”, NË SHËRBIMIN E BASHKËPUNIMIT ME ORGANIZATAT
NDËRKOMBËTARE, NË SHËRBIMIN E MARRËDHËNIEVE ME JASHTË,
PRANË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, e ndryshuar, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në përfundim të verifikimit të veprimeve administrative të kryera gjatë procesit të administrimit të shërbimit civil, në institucionin e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë,

VËREJ SE:

Pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, është regjistruar informacioni me me shkresën nr. 22 prot., datë 7.1.2026, të paraqitur nga nëpunësi Sinan Yilmaz, në lidhje me disa pretendime për vlerësim të padrejtë gjatë procesit të konkurrimit, për kandidatin në fjalë, nga ana e Komisionit të Përhershëm të Pranimit në shërbimin civil (KPP).

Referuar më tej informacionit të dërguar, rezulton se kandidati S. Yilmaz në përfundim të procedurës së konkurimit ka ngritur pretendimin se Komisioni i Përhershëm i Pranimit e ka vlerësuar me 54 pikë, vlerësim të cilin ai e konsideron jo të drejtë.

Duke mos qenë dakort me rezultatin si më sipër, kandidati ka informuar Komisionerin duke kërkuar rivlerësimin e procesit për të garantuar parimet e transparencës, objektivitetit dhe barazisë në konkurrim, me qëllim rivendosjen e gjendjes së ligjshmërisë në zbatim të kompetencave të ngarkuara nga ligji.

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pasi u njoh me pretendimet e parashtruara nga konkurrenti Sinan Yilmaz, në mbështetje të kompetencave ligjore të sanksionuara në ligjin nr. 152/2013, i ndryshuar, ka filluar kryesisht procesin e verifikimit paraprak të informacionit duke e njoftuar institucionin, nëpërmjet shkresës nr. 22/1 prot., datë 20.1.2026, me objekt “*Kërkesë për dokumentacion në lidhje me verifikimin paraprak të informacionit të administruar pranë Komisionerit, me shkresën nr. 22 prot., datë 7.1.2026, të dërguar nga kandidati Sinan Yilmaz*”, duke kërkuar dokumentacionin dhe aktet të cilat materializojnë veprimet e kryera për zhvillimin e procedurës në fjalë.

Në vijim të komunikimit, Kuvendi, me shkresën nr. 297/1 prot., datë 27.1.2026, me lëndë “*Kthim përgjigje*”, protokolluar pranë Komisionerit me nr. 22/2 prot., datë 29.1.2026 ka dërguar dokumentacionin e plotë të kërkuar.

Referuar përmbajtjes së dokumentacionit të administruar, si dhe analizës së pretendimeve të ngritura nga pjesëmarrësi në procedurën e konkurimit në fjalë, rezulton se:

Njësia Përgjegjëse e institucionit të Kuvendit, referuar legjislacionit të shërbimit civil, në të cilin normohet instituti i rekrutimit, ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar (Kreu IV, “*Pranimi në shërbimin civil*”, nenet 20, 21, 22, 23 e 25); Vendimit nr. 243, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, “*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*”, i ndryshuar, ka shpallur procedurën e konkurimit për plotësimin e pozicionit “*Specialist*”, në Shërbimin e Bashkëpunimit me Organizatat Ndërkombëtare, në Shërbimin e Marrëdhënieve me Jashtë, në portalin “*Shërbimi Kombëtar i Punësimit*” dhe në faqen zyrtare në internet të institucionit (Web).

Dispozitat ligjore të evidentuara më sipër, përcaktojnë rregullat procedurale të konkurimit, për plotësimin e pozicioneve të punës në nivelin ekzekutiv, sipas të cilave, fillimisht organizohet procedura e lëvizjes paralele, e më pas, nëse mbeten pozicione të lira, pas aplikimit të procedurës së lëvizjes paralele, njësia përgjegjëse, i plotëson ato me anën e procedurës për pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive.

Nga dokumentacioni i administruar, përsa i përket fazës së parë, asaj të lëvizjes paralele, rezulton se kjo procedurë është mbyllur pa fitues, si rrjedhojë njësia përgjegjëse ka vijuar me procedurën e pranimit në shërbimin civil.

Sipas legjislacionit që rregullon shërbimin civil, konkurrimi referuar pikës 1, të vendimit nr. 243, datë 18.3.2015, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, të Këshillit të Ministrave, i ndryshuar, përfshin dy faza, që janë:

- a) verifikimi paraprak, i cili ka për qëllim të verifikojë nëse kandidatët plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe ato të veçanta, të përcaktuara në shpalljen për konkurrim dhe;
- b) vlerësimi i kandidatëve.

Në këto kushte, Njësia Përgjegjëse e institucionit, referuar dispozitave të mësipërme ka bërë verifikimin paraprak në përfundim të të cilit rezulton të jetë kualifikuar për këtë fazë të konkurrimit kandidati Sinan Yilmaz.

Nga analiza e dokumentacionit që materializon fazat e konkurimit, të dërguar pranë Komisionerit nga institucioni, konstatohet se përsa i përket pyetjeve të testimit me shkrim, rezulton se ato janë hartuar brenda fushës së legjislacionit të përcaktuar.

Më tej, procesi ka kaluar në intervistën e strukturuar me gojë, dhe rezulton se të gjithë anëtarët prezent të KPP-së, e kanë plotësuar deklaratën e paanshmërisë dhe asnjëri prej tyre nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit me aplikantët pjesëmarrës.

Pas përfundimit të intervistës së strukturuar me gojë, KPP-ja, ka bërë renditjen e kandidatëve dhe ja ka njoftuar listën njësisë përgjegjëse, e cila në respektim të pikës 12, (brenda 24 orëve), ka njoftuar individualisht kandidatët për rezultatin e konkurrimit (njoftimi me e-mail i datës 29.12.2025).

Duke mos qenë dakort me rezultatin, kandidati S. Yilmaz, është ankuar pranë KPP-së, duke kërkuar rivlerësim të rezultatit.

Në vijim të analizës së dokumentacionit, rezulton se KPP-ja, si një organ kolegjal (referuar udhëzimit nr. 2, datë 27.3.2015, të DAP), në përgjigje të ankesës së konkurrentit në fjalë, është mbledhur për rishikim të vlerësimit, dhe në përfundim të këtij procesi, rezulton se, përsa i takon procedurës së testimit me shkrim, vlerësimit të dokumentacionit si dhe rivlerësimit të intervistës së strukturuar me gojë, rezultati ishte i njëjtë me vlerësimin e mëparshëm. Kandidati Sinan Yilmaz, pas rivlerësimit është vlerësuar përsëri me 54 pikë dhe provohet se përgjigja i është dërguar më e-mailin e datës 05.01.2026.

Në përfundim të analizës së fakteve të parashtruara më sipër, arrihet në konkluzionin se, procedura e konkurrimit e zhvilluar për plotësimin e pozicionit të punës “Specialist”, në Shërbimin e Bashkëpunimit me Organizatat Ndërkombëtare, në Shërbimin e Marrëdhënieve më Jashtë, është zhvilluar në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe Vendimin nr. 243, datë 18.3.2015, të

Këshillit të Ministrave “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive, i ndryshuar.

Për këtë arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të Ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; si dhe në mbështetje të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, e ndryshuar,

VENDOSA:

1. Përfundimin e hetimit administrativ dhe arkivimin e çështjes, të filluar në bazë të informacionit nr. 22 prot., datë 7.1.2026, të paraqitur nga nëpunësi Sinan Yilmaz, me objekt verifikimin dhe vlerësimin e ligjshmërisë së procedurës së konkurrimit për plotësimin e pozicionit “*Specialist*”, në Shërbimin e Bashkëpunimit me Organizatat Ndërkombëtare, në Shërbimin e Marrëdhënieve me Jashtë, pranë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, meqenëse procedura është kryer në përputhje me legjislacionin e shërbimit civil.
2. Të njoftohet për këtë vendim institucioni i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, si dhe nëpunësi Sinan Yilmaz.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Lefterije Lleshi (Luzi)

Konceptoi: F. Doksani

Pranoi: L. Zhapa

Miratoi: A. Basha